



KOSOVËS
REPUBLIKA
KOSOVA
VENDIMI ëSHTË PËR TIPJOISHMËM
ODLUKA JE PRAVNOSENZA
KATAN KETË
PRIZREN - OSNOVNI SUD / ASI I PIRMA
OSNOVNI SUD PRIZREN - PRIZREN

06.10.2016



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE E PRIZRENIT
OSNOVNI SUD PRIZREN – BASIC COURT OF PRIZREN

P.nr.1503/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Shpresa Emra me pjesëmarrjen e sekretares juridike - procesmbajtëses Birsen Shoshani, në çështjen penale të të akuzuarve A. Gj. , nga R e S . , të cilën e mbron av. Shehu nga Prizreni, Bjanka Dalipi nga Tirana R e Shqipërisë , të cilën e mbron av. Blend Gjini dhe F. R . , nga R e S . , të cilin e mbron av. Kc. , nga , për shkak të veprës penale kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 146 paragrafi 3 nënpar. 3.1 të KP-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1746-6/16 të dt. 15.06.2016, pas mbajtjes së shqyrimit fillestar publik në praninë e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, Prokurorit Zejnulla Gashi të akuzuarve dhe mbrojtësve, me datë 16.07.2016, publikisht mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara:

- 1.A. Gj. , nga i ati U. dhe e ëma L. e lindur Kr. , e cila ka lindur me në fshat me banim në rr. pa nr. pa shkollim, pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptare shtetase e R të Shqipërisë.
- 2.B. D. , nga i ati A. dhe e ëma R. e lindur Xh. , ka lindur më në me adresë banimi afër Stacinit trenit pa nr., e pashkollë, e papunë, e gjendjes së dobët ekonomike, shqiptare shtetase e R të Shqipërisë.
3. E. R. nga i ati A. dhe e ëma B. e lindur A. , ka lindur më në me adresë banimi pa nr. ka të kryer tri klasë të shkollës filllore, me profesion muzikant, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R të Shqipërisë

JANË FAJTORË

Se me datën 14.07.2016 rrëth orës 22,30 minuta kanë bërë kalimin ilegal të kufrit të R. , nga , në pikën e kalimit kufitar , n. , jashtë vendkalimit të autorizuar përmes rrugëve ilegale në atë mënyrë që të njejtë janë vërejtur nga Policia



kufitare dhe janë kapur që të tre të pandehurit, ndërsa i pandehuri i katërt nuk është kapur nga ana e policisë. I pandehuri E. P. dhe A. Gj., kanë pasur ndalesë dhe iu është refuzuar hyrja në Republikën e Kosovës të evidentuar me nr. të rastit për A. Gj., F. si dhe për E. me nr. vendime të cilin nuk e kishin respektuar.

Me këto veprime kanë kryer veprën penale kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 146 parografi 3 nënpar. 3.1 të KP-së.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 8, 9, 10, 41, 42, 49, 50, 51, 52, 73 dhe nenit 146 parografi 3 nënpar. 3.1 të KP-së, të akuzuarve u shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Të akuzuares A. Gj. i shqiptohet dënim me burgim me kusht, duke iu vërtetuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin kohor prej 2 (dy) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi në qoftë se e akuzuara nuk kryen vepër të re penale.

Të akuzuares B. D. i shqiptohet dënim me burgim me kusht, duke iu vërtetuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin kohor prej 2 (dy) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi në qoftë se e akuzuara nuk kryen vepër të re penale.

Të akuzuarit E. R. i shqiptohet dënim me burgim me kusht, duke iu vërtetuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin kohor prej 2 (dy) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi në qoftë se e akuzuara nuk kryen vepër të re penale.

Konform nenit 62 dhe nenit 71 parografi 1 të KP-së, kundër të akuzuarve A. Gj., B. D. dhe E. R. u shqiptohet dë:

DËNIMI PLOTËSUES

Dëbimi i të huajit nga territori i Republikës së Kosovës dhe të njëjtës i ndalohet hyrja në Republikën e Kosovës në kohëzgjatje prej 2 (dy) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të akuzuarit gjithashtu obligohen që të paguajnë shpenzimet procedurale në shumë prej 100 (njëqind) €, secili, të cilat shpenzime duhet të paguhen në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të akuzuarve A. Gj., B. D. dhe E. R. të cilët janë në ndalim në Qendrën e ndalimit të Stacionit policor që nga data 15.07.2016 ora 00.10 i ndërpritet ndalimi menjëherë dhe të njëjtë duhet të përcillen nga ana e Policisë në vendkalimin kufitar në Vërmicë dhe të dëbohen nga Kosova.

Arsyimet

Prokuroria Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm ka parashtruar Aktakuzën PP./Inr.1746-6/16 të dt. 15.06.2016, kundër të akuzuarve A. Gj.



D... dhe E... R... tē gjitha : ..., pēr shkak tē veprēs penale kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare nga neni 146 paragrafi 3 nēnpar. 3.1 tē KP-së.

Prokurori i Shtetit - Prokurorisë Themelore në Prizren, Zejnulla Gashi nē fjalën e tij ka deklaruar se mbetet nē tērësi pranë aktakuzës sē parashtruar ndaj këtu tē akuzuarve pasi qē ka prova tē mjaftueshme qē tē njëjtë e mbajnë pērgjegjësinë pēr veprën penale pēr tē cilën akuzohen dhe njëkohësisht kérkon nga gjykata qē tē shpallen fajtore dhe tē dënohen sipas ligjit.

Sa i pērket faktit qē tē akuzuarit gjenden nē ndalim nē Qendrën e ndalimit nē Stacion Policor nē ... qē nga data 15.07.2016 ora 00.10 dhe kérkesës pēr caktimin e paraburgimit Prokurori i shtetit deklaron se e tērheq kérkesën pēr caktimin e paraburgimit pēr arsyë se gjatë shqyrtimit fillestast tē akuzuarit e kanë pranuar fajësinë dhe nē këtë fazë tē procedurës Prokurori tērhiqet nga kérkesa pēr caktimin e paraburgimit.

E pandehura A... Gj... dhe mbrojtësi i saj av. D... Sh... kanë deklaruar se pranimi i fajësisë nē shqyrtimin fillestast duhet tē jetë rrethanë lehtësuese pēr tē akuzuarin dhe kanë propozuar qē gjykata tē merr parasysh këtë fakt me rastin shqiptimit tē dënimt. E akuzuara gjithashtu ka deklaruar se qëllimi i kalimit tē kufirit ka qenë vizita tek e motra sē bashku me bashkëshortin e saj këtu tē akuzuarin Ergus Roko, por se nga ana e Policisë kufitare nuk iu është lejuar hyrja nē mënyrë tē rregullt. Andaj kanë tentuar qē tē kalojnë kufirin jashtë vendkalimit kufitar zyrtar. Është penduar pēr veprimin e saj dhe ka premtuar qē nē tē ardhmen nuk do tē kryej vepër tē ngjashme penale.

E akuzuara E... D... dhe mbrojtësi i saj av. B... K... kanë deklaruar se pranimi i fajësisë është rrethanë lehtësuese tē cilën gjykata duhet tē ketë parasysh me rastin e shqiptimit tē dënimt. Gjithashtu me rastin e shqiptimit tē dënimt duhet tē mirret parasysh edhe fakti se e akuzuara nuk ka pasur ndalesë pēr hyrje nē Kosovë ashtu si e kanë pasur tē dy tē akuzuarit tē tjerë. E njëjtë është penduar pēr veprimin e saj dhe ka deklaruar se nuk do tē kryej më këtë vepër penale.

I akuzuari E... S R... dhe mbrojtësi i tij av. B... K... kanë deklaruar se pērveq pranimit tē fajësisë ekzistojnë edhe rrethanat tjera lehtësuese pēr tē akuzuarin si qē janë korrektësia para gjykatës, pendimi i thellë dhe premtimi se nuk do tē përsërit veprën penale, mosha shumë e re e tij dhe dëshira e madhe pēr tē vizituar motrën e bashkëshortes sē tij nē Gjakovë.

Gjatë shqyrtimit fillestast gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike si nē vijim:

Se me datën 14.07.2016 rreth orës 22,30 minuta kanë bërë kalimin ilegal tē kufirit të Kosovës nga Shqipëria nē pikën e kalimit kufitar nē Vërmicë, jashtë vendkalimit tē autorizuar pērimes rrugëve ilegale nē atë mënyrë qē tē njëjtë janë vërejtur nga Policia kufitare dhe janë kapur qē tē tre tē pandehurit, ndërsa i pandehuri i katërt nuk është kapur nga ana e policisë. I pandehuri F... R... dhe A... Gj... kanë pasur ndalesë dhe iu është refuzuar hyrja nē Republikën e Kosovës tē evidentuar me nr. tē rastit pēr A... Gj... si dhe pēr E... R... vendime nr. B45/2016 tē cilin nuk e kishin respektuar.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e tē akuzuarve e cila nē shqyrtimin fillestast vullnetarisht kanë pranuar fajësinë. Bazuar nē faktin



16

se të akuzuarit kanë pranuar vullnetarisht fajësinë, gjykata fare nuk është lëshuar në administrimin e provave.

Sipas detyrës zyrtare gjykata, konform nenit 257 të KPP-së, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme. Gjithashtu gjykata ka vërtetuar se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale e cila u vihet në barrë. Pranimi i fajësisë nga të akuzuarit është bërë në mënyrë vullnetare, pa kushtëzime dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat të akuzuarit kanë qenë të njoftuar me të gjitha (provat materiale).

Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së, ku bazuar në faktet që përban aktakuza në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e veprës penale kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 146 paragrafi 3 nënpar.3.1 të KP-së, andaj gjykata të akuzuarit i shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me burgim me kusht dhe dënimin plotësues, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tyre penalo juridike.

Me rastin e vendosjes mbi dënimin me kusht dhe dënimin plotësues ndaj të akuzuarve, gjykata vlerësoi - mori në konsideratë të gjitha rrëthanat në kuptim të dispozitiveve të nenit 73 të KP-së. Respektivisht mori në konsideratë dhe vlerësoi të gjitha rrëthanat të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënit. Gjykata gjatë vendosjes mbi dënimet gjeti se rrëthanë lehtësuese është pranimi e fajësisë nga ana e të akuzuarve, moshën e tyre, sjelljen korrekte me organet e ndjekjes penale, pendimin e thellë për veprën e kryer, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejnë kësi veprash penale, gjendjen e tyre të dobët ekonomike. Ndërsa sa i përket dënim plotësues gjykata konsideron se me këtë dënim plotësues do të arrihet qëllimi që të akuzuarit në të ardhmen të mos përsërisë veprën penale dhe ti nënshtrohet rregullit dhe rendit juridik.

Andaj duke marrur në konsideratë atë që u tha më lartë, gjykata konsideron së edhe me këto dënlime do të arrihet qëllimi preventiv i dënit, ku të akuzuara së parë i shqiptoi dënimin me kusht në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin kohorë prej 2 (dy) vitesh, nëse e akuzuara nuk kryen vepër të re penale dhe dënimin plotësues dëbimin e të huajit nga territori i Republikës së Kosovës dhe ndalimin e të njëjtës që të hyjë në territorin e Republikës së Kosovës në kohëzgjatje prej 2 (dy) viti.

Të akuzuara së dytë i shqiptoi dënimin me kusht në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin kohorë prej 2 (dy) vitesh, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale dhe dënimin plotësues dëbimin e të huajit nga territori i Republikës së Kosovës dhe ndalimin e të njëjtës që të hyjë në territorin e Republikës së Kosovës në kohëzgjatje prej 2 (dy) viti.

Të akuzuarit të tretë i shqiptoi dënimin me kusht në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin kohorë prej 2 (dy) vitesh, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale dhe dënimin plotësues dëbimin e të huajit nga territori i Republikës së Kosovës dhe ndalimin e të njëjtës që të hyjë në territorin e Republikës së Kosovës në kohëzgjatje prej 2 (dy) viti.

Gjykata, gjithnjë duke menduar se dënimet e shkruara i përgjigjen shkallës së përgjegjësisë së tyre penale dhe se me këto dënlime do të arrihet qëllimi i dënit që në të ardhmen të njëjtët të jenë më e kujdeshëm dhëtë përmbla që nëna veprimet e tillë.



02

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale si dhe paushallin gjyqësorë, gjykata e mori në kuptim të nenit 450, 451 dhe 453 të KPP-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr. 1503/2016 të datës 16.07.2016.

Procesmbajtësja
Birsen Shoshani



UDHËZIM JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë kësaj gjykate afatin prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apëritit Hë Prishtinë nëpërmjet kësaj gjykate.